





INDEKSI I QËNDRUESHMËRISË SË OSHC-VE 2015: SHQIPËRIA

Qershor 2016




QËNDRUESHMËRIA E OSHC-VE: 3.8



Në qershor 2014 Këshilli European i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidat. Përgjatë 2015 Shqipëria punoi për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), përfshirë reformat që adresojnë pesë prioritetet kyç rekomanduar nga BE për hapjen e negociatave për anëtarësimin: korrupsioni, krimi i organizuar, gjyqësori, reforma në administratën publike dhe të drejtat e njeriut. Në vijim të reformës administrative-territoriale në 2014, zgjedhjet vendore u mbajtën në qershor 2015 për të zgjedhur kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiakë në secilën prej 61 bashkive të sapoformuara. Papunësia dhe përhapja e ekonomisë informale mbeten sfidat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit.

Ndërsa mjedisi ligjor dhe qëndrueshmëria financiare u përmirësuan lehtësisht në 2015, dimensionet e tjera dhe qëndrueshmëria në tërësi e OShC-ve mbetën të njëjta. Ndonëse OShC-të vazhduan përpjekjet e tyre për planifikimin strategjik, zhvillimin e burimeve njerëzore, ndërtimin e bazës së mbështetësve e ngritjen e koalicioneve, dhe përdorimin e teknologjive moderne, këto nisma nuk janë sistematike apo të qëndrueshme. Progres raporti i BE për vitin 2015 vëren se ndërsa qeveria ka bërë përpjekje në drejtim të krijimit të një kuadri institucional për bashkëpunimin me shoqërinë civile, mekanizmat ekzistues për bashkëpunim nuk janë zbatuar ende plotësisht. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë raportoi 6,855 OShC të regjistruara deri në fund të 2014, të dhënat e fundit të disponueshme mbi madhësinë zyrtare të sektorit të OShC. Sipas Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile, numri i OShC-ve aktive të regjistruara pranë organeve tatimore në 2014 ishte 2,427.

MJEDISI LIGJOR: 3.8



Mjedisi ligjor për OShC-të u përmirësua gjatë 2015 me miratimin e disa akteve ligjore.

Në 27 maj 2015 Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr.459 Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile. Udhërrëfyesi përmban nëntë fusha prioritare, duke përfshirë financimin publik, bashkëpunimin qeveri-OShC, kuadrin legjislativ për regjistrimin dhe punën e OShC, zhvillimin e vullnetarizmit dhe raportimin financiar dhe trajtimin tatimor të OShC-ve dhe përvijon masa konkrete për secilën fushë. Zyra e Kryeministrit është përgjegjëse për koordinimin e Udhërrëfyesit me ministrinë dhe institucionet publike përkatëse për të zbatuar politikën e propozuara.

Ligji nr.119/2015 për Krijimin dhe Funkcionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) u miratua në parlament në 6 nëntor 2015. Ky ligj synon të institucionalizojë bashkëpunimin dhe një dialog të përherëshëm mes qeverisë dhe OShC-ve. Ligji rregullon qëllimin, përbërjen dhe funksionimin e KKSHC dhe synon të garantojë autonominë e tij. Ndërkohë, KKSHC kryesohet nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Mbledhjet e KKSHC do të mbahen në mjediset e Kryeministrit dhe procesverbalet do të afishohen në faqet e internetit të Këshillit të Ministrave dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC). Si rrjedhojë OShC-të janë skeptike mbi funksionimin e KKSHC si një organ i pavarur.

Procesi i regjistrimit vazhdon të jetë i centralizuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, duke përbërë shqetësim për OShC-të jashtë kryeqytetit. OShC-ve u nevojitet të udhëtojnë drejt kryeqytetit jo vetëm për t'u regjistruar, por edhe për të bërë ndryshime në statut përfshirë adresat. OShC-të nuk raportuan ndonjë rast diskriminimi në procesin e regjistrimit në vitin 2015.

Gjithashtu, OShC-të nuk raportuan raste të pengesave administrative apo ndërhyrje të shtetit në 2015. Sipas Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri për 2015, 85 % e drejtuesve të OShC-ve në të anketuar në nivel kombëtar deklaruan se qeveria nuk ndërhyr në qeverisjen e tyre të brendshme.

Ligji nr. 112/2015 për Inspektimin Financiar Publik u miratua në 15 tetor 2015. Ligji, i bazuar në një model të rekomanduar nga BE dhe Mbështetja për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit (SIGMA, një nismë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD) dhe BE), ka për qëllim mbrojtjen kundrejt keqmenaxhimit financiar të fondeve publike (përfshirë fondet e BE dhe donatorëve të tjerë për qeverinë), mashtrimin dhe korrupsionin. Ligji përfshin të gjitha institucionet publike dhe jo-publike, personat fizikë dhe juridikë, OShC-të dhe autoritete të tjera që menaxhojnë dhe zbatojnë fonde publike. Këto ente do të jenë subjekt inspektimi mbi bazën e një kërkesë zyrtare nga Presidenti, Kryeministri, Ministri i Financave, Prokurori i Përgjithshëm, etj., ose mbi bazën e një ankese të punonjësve. Ligji përcakton rregulla dhe procedura për të shmangur abuzimin gjatë procesit të inspektimit. OShC-të do të monitorojnë zbatimin e këtij ligji në 2016 për të vlerësuar impaktin e tij.


Urdhri nr.62 i Ministrisë të Financave Për shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve u miratua në 17 nëntor 2015 dhe hyn në fuqi në 1 janar 2016. Ai ka për qëllim standardizimin e informacionit financiar mbi pozicionin dhe transaksionet financiare të OShC-ve.

Një projekt ligj Për Punën Vullnetare u depozitua në parlament në tetor 2015. Ligji synon rregullimin e punës vullnetare me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën shoqërore, përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet dhe mbështetjen e vlerave të solidaritetit njerëzor. OShC-të përfitojnë përjashtim nga taksat dhe rimbursim të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) për blerje të kryera me grante të donatorëve. Sidoqoftë, OShC-të raportojnë se nuk morën rimbursim të TVSH në 2015. Organet tatimore nuk e zbatojnë ligjin për TVSH sipas parashikimeve ligjore, edhe pse Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka një sektor që mbulon çështjet e OShC-ve. Deklarimi elektronik i taksave iu kërkon të gjitha OShC-ve të deklarojnë shpenzimet dhe të ardhurat mujore edhe kur nuk kryejnë aktivitete, çka krijon një barrë të re administrative. Donatorët individualë apo korporatat marrin përfitime minimale për dhurimet e tyre.

OShC-të lejohen të angazhohen në veprimtari ekonomike dhe të gjenerojnë të ardhura nëpërmjet kontratave të shërbimeve dhe prokurimeve publike. Të ardhurat e fituara nga aktivitetet ekonomike përjashtohen nga TVSH për aq kohë sa aktiviteti është në përputhje me misionin e organizatës.

Kapaciteti ligjor vendor nuk ndryshoi në 2015 dhe OShC-të jashtë kryeqytetit nuk kanë ende akses në asistencë ligjore pro bono.

KAPACITETI ORGANIZATIV: 3.7



Kapaciteti organizativ i OShC-ve nuk ndryshoi në 2015.

OShC-të vazhduan të zgjerojnë bazën e tyre të mbështetësve duke përdorur Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe mediave sociale si Facebook dhe Twitter për t'iu komunikuar punën e tyre aktorëve të interesit dhe për të advokuar tek qeveria dhe donatorët. Sidoqoftë mjaft prej këtyre aktiviteteve mbeten sporadike, të bazuara në projekte dhe të kufizuara tek përdoruesit e mediave sociale. Ndërsa numri i përdoruesve të mediave sociale është në rritje, disa grupe të synuara si Romët, gratë në zona rurale dhe mosha e tretë priren të mos përfshihen.

OShC-të përpiqen të përcaktojnë misione të qarta dhe të përdorin planifikim strategjik. Sidoqoftë, sistemet e menaxhimit të brendshëm, deklarimi i misioneve dhe fusha të tjera të qeverisjes shpesh nuk i adresojnë çështjet si: monitorimi dhe vlerësimi afat-gjatë dhe besnikëria ndaj misionit në programe dhe projekte. OShC-të vijojnë të jenë tejet të varura nga axhendat dhe qëllimet e donatorëve.


Drejtorët ekzekutivë dhe anëtarët e bordit të OShC-ve vazhdojnë të kenë përgjegjësi të mbivendosura. Fare pak borde angazhohen në mënyrë aktive në qeverisjen ose monitorimin e llogaridhënies së organizatave të tyre. Veprimtaria e anëtarëve të bordit përgjithësisht nuk është transparente.

OShC-të zakonisht kanë staf të bazuar në projekte. Vetëm disa organizata në kryeqytet kanë staf të përherëshëm. Niveli i lartë i qarkullimit të stafit dhe mungesa e planifikimit të burimeve njerëzore mbetet sfida. OShC i angazhojnë vullnetarët mbi bazë ad hoc. Sipas Indeksit Botëror të Dhurimit 2015, niveli i punës vullnetare mbeti i njëjtë, me po 9 % të të anketuarve në Shqipëri që raportuan pjesëmarrjen në nisma vullnetare si në 2013 dhe në 2014.

OShC-të gjithnjë e më shumë advokojnë për financim institucional, i cili do t'u mundësonte përmirësimin e kapaciteteve për planifikim strategjik dhe zhvillim të stafit. Aktualisht, një pjesë e organizatave studimore përfitojnë nga grantet institucionale të Open Society Institute Think Tank Fund.

Akresi në internet është i përhapur në vend dhe OShC-të gjithnjë e në rritje përdorin TIK dhe platforma online pa pagesë në punën e tyre përditshme.

QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE: 4.5



OSHC-të kryesisht mbështeten nga grantet e donatorëve të huaj ose qeverisë. Megjithëse mungojnë të dhëna të sakta dhe gjithëpërfshirëse, niveli i financimit nga donatorët për OShC-të nuk ndryshoi shumë në 2015. AMSHC mbetet burimi kryesor i financimit publik për sektorin. Financimet e AMSHC kanë qenë të qëndrueshme që nga 2009. Në 2015 AMSHC shpalli dy thirrje për projekt-propozime, duke akorduar 59 grante me vlerë nga 500,000 Lekë (rreth 3.500€) deri në 3,500,000 Lekë (rreth 25.000€). Thirrjet kishin qëllim rritjen e kapaciteteve të OShC-ve me fokus kryesisht tek OShC-të e sapokrijuara, të cilat drejtohen nga të rinj dhe ndodhen në zonat rurale të vendit. Pushteti qendror dhe vendor rrallë kontrakton OShC-të për shërbime sociale.


Qëndrueshmëria financiare e OShC-ve u përmirësua në 2015 ndërkohë që mjaft donatorë nxitën partnerët e tyre të rishpërndanin fondet drejt organizatave më të vogla dhe me bazë komunitare. Gjatë 2015 Delegacioni i BE në Shqipëri shpalli dy thirrje për propozime për OShC-të në kuadër të Instrumentit European për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) dhe Programit të Përkrahjes së Shoqërisë Civile/Nismat Qytetare dhe Ndërtimi i Kapaciteteve. Përfituesve të granteve iu kërkua të rishpërndanin të paktën 70 % të vlerës së kontratës në formën e granteve të vogla për mbështetjen e organizatave lokale, nismave dhe projekteve në të gjithë vendin. Këto programe priten të përmirësojnë kapacitetet organizative dhe të rrisin veprimtarinë e organizatave me bazë komunitare të të rinjve dhe aktivistëve. Donatorë të tjerë si Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) nisën programe të ngjashme rifinancimi në 2015.

Indeksi Botëror i Dhurimit 2015 tregoi një rritje domethënëse të dhurimeve në Shqipëri me 27 % të të anketuarve që raportojnë se kishin dhuruar për bamirësi në 2014, nga 17 % në 2013. Pavarësisht nga kjo rritje, niveli i dhurimeve individuale dhe të korporatave mbetet mjaft i ulët sipas një hulumtimi të Partnerët Shqipëri në 2015. Mbështetja financiare nga sektori privat vazhdon të mbetet rastësore dhe e kufizuar. Dhurimet në natyrë janë më të shpeshta se dhurimet monetare. Dhurime të tilla zakonisht shkojnë për arsimin, grupet e marxhinalizuara (përfshirë fëmijët dhe të moshuarit) dhe për lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore.

Numri i OShC-ve të përfshira në aktivitete ekonomike mbetet mjaft i ulët. Mungesa e kuadrit ligjor për rregullimin e punës vullnetare dhe ndërmarrjeve sociale kufizon përpjekjet e OShC-ve drejt diversifikimit të bazës financiare.

Një numër shumë i vogël i OShC-ve kanë sisteme menaxhimi financiar dhe vetëm disa publikojnë raporte vjetore financiare. Me kërkesë të donatorëve, projektet individuale janë subjekt i auditimit të pavarur.

ADVOKIMI: 3.3



Pavarësisht përfshirjes së OShC-ve në një sërë nismash advokuese gjatë këtij viti, kapacitetet advokuese dhe lobuese të OShC-ve shqiptare nuk ndryshuan dukshëm në 2015. Edhe pse angazhimi i OShC-ve në konsultime me qeverinë dhe parlamentin është më i institucionalizuar si rrjedhojë e ligjeve dhe strukturave institucionale të reja, përfshirë KKSHC, mbetet ende herët për të vlerësuar impaktin e këtyre mekanizmave të rinj. Pjesa më e madhe e fushatave advokuese organizohen akoma në kryeqytet, ndërsa OShC-të lokale rrallëherë zhvillojnë fushata advokuese në zonat rurale dhe me komunitetet e largëta.

Shoqëria civile vijoi angazhimin e saj në procesin e integritit të Shqipërisë në BE. Në maj 2015 u ngrit Këshilli Kombëtar për Integrimin European me qëllim promovimin dhe garantimin e gjithëpërfshirjes në procesin e reformave që lidhen me BE. Përfaqësues të shoqërisë civile morën pjesë në të tre mbledhjet e Këshillit, por siç vëren Progres Raporti 2015 për Shqipërinë duhet akoma punë që OShC-të të marrin një rol aktiv.

Në qershor 2015 hyri në fuqi ligji nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Ligji specifikon rregullat procedurale dhe detyrimet e autoriteteve publike për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen demokratike në proceset vendimmarrëse dhe politike. Gjithashtu ligji parashikon krijimin e një regjistri elektronik ku do publikohen të gjitha projekt aktet, për t'iu siguruar të gjithë aktorëve të interesit mundësinë e dhënies së mendimit. Në tetor 2015 u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike, megjithëse afati për përfundimin e këtij procesi nuk u specifikua.


Grupime në mbrojtje të mjedisit dhe koalicionet e OShC-ve vijuan përpjekjet e tyre advokuese në 2015. Në nëntor, në vazhdim të përpjekjeve advokuese afatgjata të OShC-ve mjedisore, qeveria miratoi projekt ligjin Për Administrimin e Fondit Pyjor dhe Kullësor Kombëtar në Republikën e Shqipërisë, i cili parashikon një moratorium dhjetë vjeçar për pyjet. Në korrik grupimi Të Mbrojmë Lumenjtë, i përbërë nga shtatë OShC mjedisore, advokoi për një moratorium për ndërtimin e HEC-eve në Shqipëri. Kjo nismë nuk rezultoi e suksesshme.

Në prill 2015 parlamenti miratoi ndryshimet në Kodin Zgjedhor për rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen vendore, propozuar fillimisht nga Aleanca e Grave Deputete. Në vijim të advokacisë nga OSHC-të si Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Qendra Komunitare, Koalicioni për Nxitjen e Grave dhe të Rinjve në Politikë u vendos një kuotë gjinore prej 50 % për përfaqësimin e grave në listat zgjedhore për këshillat bashkiakë para zgjedhjeve vendore të qershorit 2015.

Shoqëria civile në nivel kombëtar u konsultua për ligjin nr. 119/2015 Për Krijimin dhe Funkcionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe për Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikës dhe Masave për një

Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile. Gjatë këtyre konsultimeve shqetësimet e shoqërisë civile ishin të fokusuara tek autonomia e KKSHC. Shoqëria civile gjithashtu mori pjesë në disa takime konsultuese për projekt ligjin e Punës Vullnetare në 2015.

OFRIMI I SHËRBIMEVE: 3.7



Përfshirja e OShC-ve në ofrimin e shërbimeve në Shqipëri nuk ka ndryshuar dukshëm që nga 2008. Shërbimet sociale bazë në fushën e shëndetit dhe arsimit, ndihmat dhe strehimi përbëjnë pjesën më të madhe të shërbimeve të ofruara nga OShC-të lokale. Shërbime të tilla synojnë grupe specifike shoqërore si komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE), gratë, fëmijët dhe grupe të tjera të marxhinalizuara ose vulnerabël. Ndërkohë, OShC-të me përvojë, pjesa dërrmuese e të cilave me bazë në Tiranë, vijojnë të ofrojnë një gamë të diversifikuar shërbimesh, që nga rritja e kapaciteteve dhe deri te monitorimi dhe vlerësimi i nismave dhe projekteve.

Shërbimet e OShC-ve përgjithësisht reflektojnë nevojat vendore, duke qenë se OShC-të konsultohen në terren kur planifikojnë shërbimet. Sidoqoftë disponueshmëria e shërbimeve varet në një masë të madhe nga disponueshmëria e financimit të huaj.


Strategjia Kombëtare Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, e miratuar në 29 korrik 2015, ofron më shumë mundësi për bashkëpunimin midis qeverisë vendore dhe OShC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale. Sidoqoftë mbetet për t'u parë nëse ky bashkëpunim do të konkretizohet në praktikë.

Organizatave me bazë anëtarësie, si dhomat e tregtisë, u ofrojnë rregullisht anëtarëve dhe përfituesve të tjerë rritje të kapaciteteve dhe shërbime të tjera trajnuese me fokus menaxhimin e biznesit, menaxhimin financiar dhe shkrimin e projekt-propozimeve. Organizatat e tjera me bazë anëtarësie, si organizatat sindikale, zakonisht u ofrojnë shërbime për rritjen e kapaciteteve anëtarëve kur ka financim nga donatorët.

Përgjithësisht OShC-të nuk paguhen për shërbimet e ofruara. OShC-të ofrojnë pjesën më të madhe të studimeve, publikimeve dhe trajnimeve pa pagesë duke qenë se donatorët mbulojnë shumicën e shpenzimeve. Edhe kur OShC-të tregtojnë shërbimet e tyre në disa raste të kufizuara, të ardhurat e mbledhura rrallëherë mbulojnë kostot e shërbimeve të ofruara. Përfituesit e shërbimeve sociale bazë nuk përballojnë dot të paguajnë dhe presin që shërbimet të jenë pa pagesë.

OShC-të janë të lejuara ligjërisht të marrin pjesë në proceset konkurruese në prokurimet publike. Sidoqoftë, sipas Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri për 2015, 44 % e të anketuarve e vlerësojnë nivelin e fondeve të marra nga OShC-të nëpërmjet prokurimit publik si të pamjaftueshëm për të mbuluar kostot e shërbimeve të kontraktuara.

INFRASTRUKTURA: 3.8



Infrastruktura për mbështetjen e shoqërisë civile nuk ndyshoi dukshëm në 2015.

Asistenca Teknike e BE për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO) vijoi të mbështesë OShC-të me synim rritjen e pjesëmarrjes në skemat e granteve të BE. Gjatë 2015, TACSO iu ofroi 45 OShC-ve shqiptare trajnime të fokusuar në zhvillimin organizativ, menaxhimin dhe marrëdhënien me publikun. Mbështetja e AMSHC për OShC-të ishte e kufizuar tek sesionet informuese dhe asistencën teknike për thirrjet e AMSHC për projekt-propozime. Në 2015 AMSHC mbajti procese konsultative lidhur me prioritetet kryesore të thirrjeve dhe ofroi trajnime për kandidatët fitues në çështje të raportimit.

Disponueshmëria e granteve në nivel vendor u rrit në 2015 si rezultat i programeve të donatorëve që theksuan rishpërndarjen e granteve drejt organizatave vendore.

OShC-të janë të vetëdijshme për rëndësisë e koalicioneve dhe rrjeteve. OShC-të formojnë koalicione dhe rrjete në bazë interesash tematikë dhe brenda fushave të caktuara. Disa nga rrjetet më aktive në 2015 ishin përqëndruar tek gratë dhe çështjet gjinore, rinia, monitorimi i zgjedhjeve dhe problemet mjedisore.


Në 2015 u formuan disa koalicione me bazë tematike. Gjatë zgjedhjeve vendore të qershorit, koalicione të çështjeve zgjedhore bashkuan burimet për rritjen e sensibilizimit dhe të monitorimit. Dhoma Zgjedhore, një platformë koordinimi e OShC-ve lokale, ndërmori monitorimin e zgjedhjeve dhe publikoi një sërë deklaratash dhe raportesh. Faqja e saj ofroi një mekanizëm për qytetarët për raportimin e parregullsive zgjedhore. Në 2015, njëzet e një OShC rinore dhe pesë forume rinore politike krijuan Rrjetin Kombëtar të të Rinjve në Shqipëri (RKRS) për të promovuar çështjet e të rinjve në nivel vendor dhe kombëtar.

Disa OShC me përvojë ofrojnë trajnime për OShC-të vendore. Në mars, Partnerët Shqipëri iniciuan Akademinë e Organizatave Jofitimprurëse për të ofruar arsim jo-formal për sektorin. Akademia zhvilloi programet e saj të para trajnuese gjatë vitit, duke rritur kapacitetet e pesëmbëdhjetë drejtuesve të organizatave lokale në ndërtimin e organizatave efektive. Gjithsesi sektori vazhdon të ketë kërkesë për mbështetje teknike cilësore dhe trajnim në fushat e planifikimit strategjik afat-mesëm dhe afat-gjatë, ngritjen e fondeve, menaxhimit financiar dhe burimeve njerëzore.

Gjatë 2015 OShC-të zbatuan një sërë nismash dhe projektesh të përbashkëta me qeverinë qendrore dhe vendore. Progres Raporti 2015 i BE për Shqipërinë vlerësoi si pozitiv bashkëpunimin e shoqërisë civile me Avokatën e Popullit. Përgjatë vitit Avokati i Popullit dhe OShC-të punuan bashkë për realizimin e një sërë trajnimesh të përbashkëta në tema si të drejtat e njeriut, të drejtat e komunitetit LGBT (Lezbike, Gej, Giseksualë dhe Transgjjinorë) dhe përfshirjen e Romëve. Ndërkohë, partneriteti ndërsektorial me biznesin mbetet i kufizuar. Në korrik Fondacioni për Shoqërinë e Hapur dhe Instituti Harry Fultz nisën Ofiçina, një

laborator sipërmarrjeje dhe inovacioni, i cili funksionon nëpërmjet partneritetit me sektorin privat, qeverinë vendore, akademinë dhe organizatave të komunitetit për të mbështetur tranzicionin e Shqipërisë drejt ekonomisë së dijes.

IMAZHI PUBLIK: 3.7



Imazhi publik i sektorit mbeti i njëjtë në 2015.

OShC-të vijojnë të gëzojnë mbulimin mediatic të mediave tradicionale mbi nisma të ndyshme dhe fushata advokuese në tema si transparenca, qeverisja e mirë, korrupsioni, llogaridhënia, çështjet gjinore e mbrojtja e fëmijëve si dhe mbrojtja e mjedisit. Sidoqoftë, raportimet e medias mbi aktivitetet e OShC-ve priren të jenë sipërfaqësore dhe të mos thellohen në veprimtarinë e OShC-ve. Mediat kombëtare kryesisht mbulojnë OShC-të me bazë në Tiranë, duke qenë se ekspertiza e tyre konsiderohet gjerësisht e besueshme. Stacionet televizive lokale mbulojnë aktivitetet e OShC-ve vendore.

Perceptimi publik për OShC-të mbetet i dobët. Sipas sondazhit të opinionit publik të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim në nëntor 2015, 38 % e shqiptarëve kanë besim tek OShC-të krahasuar me 34 % në vitin 2014. Studimi i marsit 2015 i Qendrës Rajonale të Mjedisit Shqipëri tregon se 65.3 % e Shqiptarëve besojnë tek OShC-të mjedisore dhe i shikojnë si burime të besueshme informacioni për mbrojtjen e mjedisit, edhe pse vetëm 28.5 % e tyre i përdorin rregullisht OShC-të si burime informacioni.

Qeveria ka njohur rëndësinë e OShC-ve siç dëshmohet nga angazhimi për rritjen e bashkëpunimit me OShC-të dhe për krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile. Sidoqoftë, perceptimet ndaj OShC-ve si të 'orientuara nga fondet' dhe 'oportuniste' ende shpërfaqen ndërmjet qeverisë dhe biznesit.

Megjithëse OShC-të përdorin TIK dhe mediat sociale si Facebook dhe Twitter për të komunikuar punën e tyre ndaj palëve të interesuara, OShC-të vazhdojnë të kenë aftësi të dobëta të marrëdhënieve me publikun për shkak të burimeve të kufizuara. Gjatë 2015 OShC-të në bashkëpunim me institucionet publike organizuan dy panairë të shoqërisë civile për të rritur vizibilitetin e sektorit. Në tetor, Panairi i Organizatave të Shoqërisë Civile i mundësoi publikut dhe palëve të interesuara njohjen me punën dhe veprimtarinë e OShC-ve. Në dhjetor, Panairi i Organizatave Rinore u mbajt me qëllim rritjen e vizibilitetit dhe qëndrueshmërinë e punës së organizatave rinore.

Në tërësi sektori nuk është i vetë-rregulluar dhe OShC-ve iu mungon transparenca në veprimtarinë dhe financat e tyre. OSHC nuk kanë një kod etike të pranuar gjerësisht, edhe pse disa OShC individuale kanë hartuar kodin e tyre të sjelljes dhe etikës. Pak OShC publikojnë raportet e tyre vjetore në rrjet edhe pse të gjitha dorëzojnë raport vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Indeksi i Qëndrueshmërisë së Organizatave të Shoqërisë Civile (CSOSI) është një mjet analitik thelbësor që mat progresin e sektorit të shoqërisë civile në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Euroazisë. Indeksi mat progresin e sektorit të shoqërisë civile në njëzetëntë vende gjatë nëntëmbëdhjetë viteve të fundit. Indeksi analizon mjedisin përfshirës të përgjithshëm për shoqërinë civile duke u përqendruar tek mjedisi ligjor për OJF-të, kapacitetet organizative, qëndrueshmërinë financiare, advokimin, ofrimin e shërbimeve dhe imazhin publik. Secili prej dimensioneve vlerësohet sipas një shkalle prej shtatë pikësh ku 1-tregon një nivel mjaft të avancuar dhe 7 - tregon nivel të ulët zhvillimi. Indeksi zhvillohet nga Agjencia e ShBA për Zhvillim Ndërkombëtar në partneritet me organizata vendore për secilin prej vendeve që përfshihen në indeks.

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim në info@idmalbania.org.

Versioni anglisht i Indeksit të Qëndrueshmërisë së Shoqërisë Civile për VITIN 2015 për Evropën Qendrore dhe Euroazinë mund të gjendet duke vizituar linkun: <http://www.usaid.gov/europe-urasia-civil-society>